



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.761/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada- Gllogjani dhe Adnan Konushevci anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Malsore Cakiqi, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Drenasit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara apelet Anr.761/2021, Anr.762/2021 dhe Anr.763/2021 të gjitha të datës 03.11.2021, të paraqitura nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Malsore Cakiqi, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Drenasit.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumërojë vetëm fletëvotimet për kandidaten për anëtare të Kuvendit Komunal të Drenasit Malsore Cakiqi nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Vendvotimet 0319E/03D, 0325E/02D dhe 0318E/01R në komunën e Drenasit.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar apelet Anr.761/2021, Anr.762/2021 dhe Anr.763/2021 të gjitha të datës 03.11.2021, të paraqitura nga Malsore Cakiqit, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas me të cilat pretendon

se në vendvotimin 0319E/03D i ka dalë vetëm 1 (një) votë në të cilin pretendon se duhet ti kishte së paku pesë vota pasi që edhe dy familjar të saj kanë deklaruar se e kanë votuar, në vendvotimin 0325E/02D i kanë dalë 14 (katërbëdhjetë) vota në të cilin pretendon se duhet të kishte më shumë vota pasi që edhe mbi 16 (gjashtëmbëdhjetë) persona kanë deklaruar se e kanë votuar. Po ashtu edhe në vendvotimin 0318E/01R pretendon se i ka dalë vetëm 1 (një) votë derisa tre persona kanë deklaruar se e kanë votuar. Si provë krahas këtyre apeleve ka bashkangjitur deklaratat e 21 personave si dëshmi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli duke vepruar konform Rregullës Nr. 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, përkatësisht në bazë të nenit 13.2 *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendosë ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim”* ka bashkuar apelet Anr.761/2021, Anr.762/2021 dhe Anr.763/2021 duke i trajtuar si një apel i evidentuar Anr.761/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim, i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Malsore Cakiqi, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i votave në Vendvotimet 0319E/03D, 0325E/02D dhe 0318E/01R në komunën e Drenasit.

Paneli vlerëson se apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidatja, ku shihet qartë se nga deklaratat e gjithsej 21 (njëzetënjë) votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës me deklarin se në vendvotimet 0319E/03D, 0325E/02D dhe 0318E/01R kanë votuar për kandidaten Malsore Cakiqi me numrin 18 nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Në këto vendvotime, gjithsej kanë rezultuar 16 vota për kandidaten në fjalë derisa nga deklaratat në shkresat e lëndës rezulton të jenë 21 vota gjë që në rastin konkret kemi të bëjmë me mospërputhje të votave dhe votuesve në këto vendvotime.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117 par 4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i votave, vetëm për kandidaten për Kuvend Komunal të Drenasit Malsore Cakiqi nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi i dhe 120 Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.761/2021 më datën 05.11.2021

Kryesues i Panelit

Ferki Xhaferr



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.